

LIGJ
Nr.7670, datë 9.2.1993

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7582, DATË 13.7.1992 "PËR NDËRMARRJET
SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1992 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 6 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", të shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

"Ndërmarrjet dhe personat e tjerë juridikë shtetërorë jobuxhetorë lejohen të marrin e t'i japin kredi subjekteve shtetërore a privatë për blerjen dhe shitjen e mallrave dhe shërbimeve të tyre".

Këshilli i Ministrave rregullon me dispozita të veçanta kushtet dhe afatet specifike të këtyre kredive".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.462, datë 16.2.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha